

Dr. Fatmir XHAFERI

## NJË FJALOR I RI ANGLISHT-SHQIP

Kohë më parë doli nga shtypi “Fjalor anglisht-shqip”, hartuar nga prof. dr. Hajri Shehu, punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Fjalori është botuar nga EDFA. Si bashkëbotues, por njëherësh edhe si recensues, bashkë me autorin e mirënjohur të disa fjalorëve anglisht-shqip, zotin Pavli Qesku, kam pasur rastin që ta shoh e ta kundroj këtë fjalor. Me kënaqësi mund të them se fjalori ka mëtime të larta, trajtim leksikografik shkencor, vlera shkencore njohëse, praktike e didaktike e pse jo, edhe përkthimore. Zëri në fjalor (fjala), me shqiptimin me tejskrim ndërkombëtar, përcaktimi gramatikor (emër, mbiemër etj.), përdorimi sipas fushës terminologjike (botanikë, kimi etj.), statusi social (bisedore, librore etj.), barasvlerësit, thëniet ilustruese etj. e bëjnë vërtet një fjalor të besueshëm dhe bashkudhëtar besnik për përdoruesin.

Fjalori ka mbi 30 000 fjalë, mbi 90 000 kuptime dhe mbi 150 000 thënie ilustruese. Si një pjesë e dytë janë disa shtojca: *Tabela dhe shënime* (tipi: *No smoking!* Ndalohet duhani!) – si një udhëregues në një mjedis të huaj; *Emërtime profesionale dhe mjeshtërish* (rreth 700) – mirëfilli, një minifjalor tematik; *Barasvlerës të anglishtes amerikane për anglishten britanike* – për të dalluar raste të veçanta ligjërimore amerikane; *Shkurtime dhe shkurtesa* (me një poshtëshënim për mënyrën si bëhet shkurtimi në gjuhën angleze dhe si lexohen shkurtime e shkurtesat); *Emra gjeografikë dhe banorët sipas tyre* – në anglishte dhe në shqipe, banorët dalin me larmi prapashtesash e kështu janë mirëfilli edhe lëndë për studim; *Vende dhe gjuhë* – sigurisht, jo vetëm për kureshtje; *Rregulla të*

*leximit dhe të shkrimit në gjuhën angleze* – një teknikë shumë e dobishme për të lexuar dhe shkruar pa gabime; Një tabelë, *Fjalë të vështira për t'u shkruar; Dysi a grupe fjalësh të ngatërrueshme* (krahaso në shqipe *mishëroj / mëshiroj, shekullor / shekullar* etj.); *Fjalëformimi në gjuhën angleze* – i thukët, por i plotë e transparent; *Gramatikë e gjuhës angleze* (për të gjitha pjesët e ligjëratës); Tabela *Zgjedhimi i foljes* (vetëm në një faqe janë të gjitha mënyrat e kohët e foljes) etj. Nuk e teprojmë, atëherë, po të themi që në këtë libër është e tërë gjuha angleze.

Fjalori është edhe për ata që dinë shumë, edhe për ata që dinë më pak a pak. Ai shpalos anglishten standarde dhe, sigurisht, edhe shqipen standarde në shtyllën përkthimore. Ai e ndihmon përdoruesin të lexojë, të flasë e të shkruajë në gjuhën angleze. Ai është fjalor tryeze, por njëherësh, edhe i mbartshëm në çantë.

Fjalori është i tipit aktiv (kjo thuhet në parathënie), që do të thotë se ai përfshin fjalë të leksikut të sotëm. Ato janë fjalë të gjuhës së përditshme, por edhe të politikës, të ekonomisë, të shkencës, të teknikës, të mjeteve të informimit masiv etj. Në fjalor vihen si zë më vete edhe ndajshitesat (tipi *-less*). Në këtë mënyrë, përdoruesi i kupton ato si një veçori të gjuhës angleze dhe motivon e përgjithëson kështu formimet me to. Pasqyra e plotë e tyre jepet, siç u tha, te *Shtojcat*.

Në një fjalor dygjuhësh çështja themelore është *barasvlerësia* (ekuivalenca). Por hartuesi i bashkërendon fjalët e shprehjet e të dyja gjuhëve. A është e lehtë? Sigurisht, jo. Për shumë arsye. Nuk është vendi t'i përmendim. Por, nga sa kam hulumtuar, del se autori e ka pasur kujdes të veçantë e të vijueshëm punën e barasvlerësve. Do të mjaftohem duke dhënë vetëm pak shembuj nga zgjidhjet e tij për barasvlerësinë.

1. Renditja e kuptimeve është e tillë që përmbush synimin

kryesor të Fjalorit: të japë përkthimin e duhur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Fjalori dygjuhësh është mjet përkthimi dhe prandaj barasvlerësit duhet të rrokten e pse jo, të mbahen mend. Për këtë arsye, kuptimet janë grupuar sipas një ndërveprimi të pandërprerë ndërmjet strukturës kuptimore të gjuhës angleze dhe barasvlerësit të mundshëm të gjuhës shqipe (shih, p.sh., *te night, short, time* etj.).

2. Dihet se gjuha angleze është shumë e pasur me sinonime, me fjalë të afërta për nga kuptimi ose përdorimi. Në raste të tilla, autori ka menduar se nuk është krejt i mjaftueshëm barasvlerësi në gjuhën shqipe dhe jep në kllapa dallimet a ngjyrimet që kanë ato, çka do të thotë që nuk lihet vend për moskuptime a keqpërdorime. Ky nuk është vetëm informacion, por edhe nevojë. Komenti bëhet në gjuhën shqipe. Ai është i thjeshtë, i kuptueshëm dhe me shembuj përqasës e krahasues (shih, p.sh., tek *eatable* e *edible*, *historic* dhe *historical*, *magazine* dhe *journal*, *put off* dhe *take off*, *you* dhe *one* e dhjetëra e dhjetëra të tjera). Mendoj se kjo zgjidhje është shumë e rëndësishme, sidomos në një fjalor aktiv, që është edhe për ata që dinë më shumë, edhe për ata që dinë më pak, por, sidomos për këta të fundit. Pse? Sepse u duhet të zgjedhin siç duhet barasvlerësin për një bisedë, hartim, ese etj.

3. Shpesh jepet në kllapa një sinonim në gjuhën angleze, tashmë, për të treguar se ky (sinonimi) mund të parapëlqehet. Kjo është një tjetër zgjedhje dhe zgjidhje.

4. Nganjëherë jepen edhe barasvlerës alternativë, kur fjala ka disa ngjyrimë kuptimore, por pa e errësuar përmbajtjen e saj kuptimore.

5. Në fjalët shumëkuptimëshe (janë fjalë që kanë disa a shumë kuptime), autori jep fushën e përdorimit a ngjyrimin stilistik (tipi: edhe *tek.*, ose: edhe *fig.*, që do të thotë se fjala ka një kuptim të

përgjithshëm, por me këtë kuptim përdoret edhe në teknikë, ose edhe si i figurshëm).

6. Togfjalëshat e qëndrueshëm (njësitë frazeologjike), fjalët e urta e proverbat e gjuhës angleze, sigurisht duhen paralelizuar në gjuhën shqipe. Në ç'mënyrë? Duke gjetur ngjashmëritë në të dyja gjuhët (tipi *come to light = del në dritë*) e më shumë se kaq, duke gjetur vetë shprehjen, fjalën e urtë a proverbin në gjuhën shqipe (krahaso, p.sh. *Make hay while the sun shines* – ky është motivimi anglez: *Kosite barin sa ka diell*; në shqip është dhënë: *Rrihe hekurin sa është i nxehtë* – motivim i neve shqiptarëve).

Në këtë fjalor, thëniet ilustruese me mbushulli, sigurisht, më së pari, në fjalët më të kërkuara, janë shumë të dobishme. Për disa arsye kryesore. Ato luajnë rol të rëndësishëm në procesin e perceptimit. Ato janë një ndër faktorët determinues për të formuar konceptin a nocionin që shpreh fjala, ose, siç thotë autori në parathënien e vet, thënia “tregon pa dykuptimësi ç'përmban një fjalë”. Ato përforcojnë barasvlerësin shqip, sepse e bëjnë më të qartë kuptimin. Ato tregojnë shkallën e përdorimit të fjalës – ku duhet përdorur dhe si duhet përdorur. Ato shërbejnë si gjedhe (modele) për përdoruesin për të krijuar vetë bashkëlidhje analoge fjalësh. Hapeni Fjalorin për kënaqësinë tuaj e shihni për këtë, p. sh., te *lesson, book, visa* etj.

Informacioni përshkrimor në një fjalor dygjuhësh është shumë i rëndësishëm, gjithashtu. Përdoruesi do të dijë nëse një fjalë a shprehje është formale a informale dhe kur, në ç'rast mund të përdoret (p.sh., një fjalë bisedore a të ligjërimit të thjeshtë, siç dihet, nuk mund ta përdorësh në një mjedis jofamiljar). Ky fjalor e bën këtë, siç u cek me shënimet *bised., ligj. thj.* etj. Shënime të tilla, si ato gjuhësore (tipi: *bised. libr.*), ashtu edhe ato sociale (tipi: *përçm.* = me përçmim, *përb.* = me përbuzje etj.) janë dhënë me

kujdes të posaçëm.

Më në fund, mendoj se Fjalori i jep përdoruesit edhe edukatën gjuhësore e, sidomos, leksikografike, domethënë e ndihmon përdoruesin si ta njohë gjuhën angleze, si ta përdorë fjalorin e, veçanërisht, si ta përdorë fjalën, ç’janë shënimet që kufizojnë përdorimin e një fjale, të një kuptimi etj., ç’është çerdhja e fjalës etj. Këtë të fundit dua ta vlerësoj posaçërisht. Ajo (çerdhja e fjalës) është dhënë me një teknikë të veçantë. Thjesht, me një vështrim, përdoruesi rrok renditjen e “pjesëtarëve të familjes së fjalës” pas çdo fjale titull. Në këtë mënyrë, përdoruesi kupton se cilat fjalë u lidhkan me fjalën titull e si u lidhkan. Përfundimi: mësohet më lehtë e mbahet mend më shumë fjala. Përfundimi: mësohet si u rritka gjuha.

Duke përmyllur vlerësimin tim, do të doja të thosha se është vërtet një fjalor për të mësuar gjuhën angleze në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Për këtë arsye, besoj se do të përdoret gjerë.